Publikohet vendi vakant Punonjes Pastrimi në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse, në Drejtorinë e Finances dhe Sherbimeve Mbeshtetese, ne Agjencine e Administrimit te Pasurive te Sekuestruara dhe te Konfiskuara:

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin:

Të mbaje paster ambientet e institucionit, të paraqesë te drejtuesi nevojat për furnizim me materialet e nevojshme bazë, për të mbajtur sa më të pastër higjenën në ambientet e zyrave, te kujdeset per mireadministrimin e mjeteve të pastrimit; te kujdeset per higjenen dhe rregullat e sigurisë.

Kriteret e pergjithshme:

- Të jetë shtetas shqiptarë;
- Të kenë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- Të zotërojnë diplomë në arsimin 9vjecar/e mesëm.

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- Kerkese drejtuar institucionit,
- Jetëshkrim;
- Fotokopje të diplomës se arsimit perkates, e noterizuar.
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- Vetedeklarim I gjendjes gjyqesore.

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara sa më sipër, së bashku me një kërkesë ku ju specifikoni pozicionin ku dëshironi të konkurroni, duhet të dorëzohen ne rruge postare pranë Agjencise se Administrimit te Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara brenda dates 25.11.2026.